



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Datë: 06.07.2018

**Pyetje nga përfituesit dhe përgjigje nga MZHR-ja lidhur me
implementimin e projekteve të Skemës së granteve “Programi i
Zhvillimit Rajonal të Balancuar” PZHRB 2018**

1. A duhet llogaria bankare të jetë llogari biznesi apo personale?
- *Te gjithë përfituesit duhet të sjellin llogarinë bankare të biznesit përfitues si dhe Lot 1 që kanë hapur biznesin duhet të sjellin në MZHR llogarinë bankare në emër të biznesit (jo personale);*
2. A llogaritet TVSH-ja dhe a jemi të liruar nga dogana për pajisjet që duhen blerë jashtë vendit?
- *TVSH është shpenzim i pranueshëm vetëm për persona fizik dhe ndërmarrje joraportuese të TVSH-së. Për ndërmarrjet raportuese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshëm!. Në këtë adresë të internetit: <http://apps.atk-ks.org/BizPasiveApp/VatRegist/SearchVat> mund të shkarkohen raportet me të cilat mund të vërtetohet nëse biznesi është raportues apo jo i TVSH-së (Shih udhëzuesin për aplikant pika 2.7.);*
3. A lejohen ndryshime tek pajisjet (funksioni të jete i njëjtë por modeli të jetë i ndryshëm)?
- *Nëse është fjala për të njëjtën pajisje që kryen funksionin e njëjtë por vetëm brendi ndryshon, konsiderojmë që është në rregull vetëm paraparakisht duhet të njoftojnë MZHR dhe të japin arsyetimin me qellim të verifikimit të ndryshimit me projektin e aprovuar;*
4. A lëshon Ministria ndonjë dokument që tregon se lirohemi nga TVSH-ja (pasi që BE-ja e kanë të zgjidhur këtë çështje me vërtetim që lirohen nga TVSH-ja dhe dogana)?
- *MZHR nuk lëshon ndonjë dëshmi për lirim nga TVSH dhe Dogana, të gjitha blerjet dhe furnizimet i nënshtrohen tatimeve dhe taksave të aplikueshme në RKS;*

5. Si duhet vepruar kur ka vetëm një furnizues (monopol) të pajisjeve (makinerive) në Kosovë?

- Duhet të sigurohen tri oferta nga rajoni apo me gjerë, për të reflektuar transparencën;

6. A lëshon ministria ndonjë letër mbështetëse që do ti lehtësohet aplikantit marrja e vizës për vendet jashtë Kosovës?

- JO;

7. Nëse makineria e blerë është me e lirë, a kthehen mjetet e tepruara?

- Mund të zbritet vlera e bashkëfinancimit tuaj;

8. Kur jepet avanci i parë?

- Afati për të bërë kërkesë për avanc (këstin e pare për pagës) është deri me 13.07.2018

Pas pranimit të dokumentacionit të kompletuar, MZHR brenda afateve zyrtare do të ekzekutoj pagesën;

9. Si duhet vepruar në rastet kur firma nuk i lëshon firmës kupon fiskal por vetëm fatura?

- Duhet të bëhet pagesa me transaksion bankar bazuar në faturë;

10. Sa anëtarë të komisionit për oferta duhet të jenë (tek procedurat e hapura të kontraktimit)?

- Komisioni duhet të jetë në përbërje prej 3 (tre) anëtaresh;

11. A është ndonjë afat i caktuar për marrjen e ofertës (a mundemi me i marrë tri oferta brenda një dite)?

- Nuk ka ndonjë afat të caktuar për marrjen e ofertave, por ofertuesve duhet ti jepet një afat për të kthyer përgjigje;

12. Pse duhet me pas profaturë për pjesën e pare të avancit (çka duhet me u ceke në të)?

- Formën e profaturës ju kemi përcjell të gjithë përfituesve në mënyrë elektronike dhe mund ta gjeni ne uebfaqen e MZHR-së;

13. A lejon ministria që përfituesi me bashkëfinancu më shumë se shumën e premtuar dhe 10% që ju lejohet?

- Për çdo ndryshim paraprakisht duhet të behet kërkesë me shkrim në MZHR;

14. Nëse përfituesi e blen një makineri ne një kompani siç është p.sh "Siemens" dhe dihet se kjo kompani nuk lëshon certifikate biznesi, a paraqet ndonjë problem?

- Për blerjet jashtë vendit shiko versionin e fundit "Udhëzuesi me plotësime për procedurat e hapura të kontraktimit lidhur me blerjen e pajisjeve/shërbimeve të parapara në projekt";

15. A bën që me mjete financiare personale me i ble mjetet edhe para avancit të parë?

- Duhet të ndiqni procedurën e furnizimit sipas udhëzimeve të publikuara në uebfaqe të MZHR-së;

16. A duhet të bëhet ofertë për marketing nëse e kalon vlerën e shumës prej 1,000.00 euro?
- PO;

17. A mundemi të ndryshojmë specifikacionin e produktit pa ndryshuar fusha e projektet?
- Për çdo ndryshim paraprakisht duhet të bëhet kërkesa me shkrim në MZHR;

18. Avanc garancioni a duhet të ketë vlerën e bashkëfinancimit të përfituesit apo vlerën totale të projektit?
- Avanc garancioni duhet të ketë shumën e kështit të parë (avancit) në shumë prej 70% për LOT 1 dhe 50% për LOT 2 dhe 3 të grantit të financuar nga MZHR;

19. Ndryshim të pajisjeve/ nëse çmimi është më i ulët a mund të blihen pajisje shtesë?
- JO/ mund të zbritet vlera e bashkëfinancimit;

20. A duhet të jete materiali apo shërbimi nga Kosova/ vendi i origjinës apo mund të jete ngado (Kine, Serbi, Maqedoni, etj.)?
- Nuk ka kufizime se ku duhet të bëhet blerja;

21. Si të veprohet nëse kanë ndryshuar çmimet në treg?
- Vlera e grantit nuk mund të rritet përveç nëse ka shpenzime të pakualifikueshme mund të zbritet;

22. Për sa kohe duhet të jetë garacioni bankar?
- Garacioni bankar ose garacioni nga kompania e sigurimeve duhet të jetë aq sa zgjat implementimi i projektit (6 muaj);

23. Sa parashihet të jetë koha e pagesës së fundit nga MZHR-ja, që nga kërkesa e deri te ekzekutimi i pagesës finale?
- Pas implementimit të projektit bëhet edhe kërkesa për pagesën e kështit të dytë (fundit) siç është e specifikuar në kontratë.